

**AKT THEMELIMI
ISHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Inovita “ SHPK.**

Në Tirane, sot më datë 01/06/2022 shtetasit shqiptare si me poshte:

1. Olsi Zoto , lindur me 29.03.1991, ne Lushnje , banues Tirane, pajisur me mjet identifikimi,pajisur me pasaporte me Nr: J10325120D
2. Elvis Sina, lindur me 14.11.1978, ne Tirane dhe banues ne Tirane, pajisur me mjet identifikimi karte identiteti Nr: H81114073C
3. Abdurrahim Palushi lindur me 03.02.1969, ne Palush , banues ne Tirane, pajisur me mjet identifikimi, Karte Identiteti Nr. G90203138M.

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ kane rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklaron se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqerinë tregtare,te quajtur , “Inovita” Sh.p.k

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “Inovita “ *Shpk*, është person juridik i të drejtës shqiptare, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “Inovita “ *Shpk*.

Neni 3
Selia

Tirane,Kamez,Paskuqan,Rruga “Azem Galica”, ZK 2884, Pasurija NR 253/1-N1.Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Aktivitet klinike mjekesore me te gjitha sherbimet (Vizita mjekesore te spicialiteteve te ndryshme ne fushen e mjekesise,diagnostikimit,mjekim,terapi ditore dhe sherbime te tjera mjekesore,nanliza te ndryshme,konsulta dhe keshillime mjekesore,check up etj).Importim te paisjeve mjekesore ne funksion dhe ne sherbim te aktiviteit te perditshem te shoqerise. Import-esksport te produkteve farmaceutike,dentare,dermatologjike,okulistike. Import-eksport te produkteve bimiore,shtesa ushqimore etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 1000(nje mijë) Lekë. Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më posht:

1. Ortaku themelues:Olsi Zoto zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme330 Leke, që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2.Ortaku themelues Elvis Sina zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme330 Leke, që përben33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3.Ortaku themelues Abdurrahim Palushi zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 340 Leke, që përben 34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shítblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- e) orkaket kane te drejte tju trashgojne kuotat e tyre bashkeshortes/bashkeshorit dhe femijeve.
- f)ne rast se ndonjeri nga ortaket deshiron te shes kuotat perkatese, duhet tu japi prioritet fillimisht ortakeve te tjere nese ata jane te interesuar ne blerjen e tyre, nese asnje nga ortaket nuk shfaq interes ai ka te drejt te shesi kuotat e veta paleve te treta te interesuara.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e

regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organë Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria eshte e themeluar nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvëç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të

cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqerise eshte **Olsi Zoto** pajisur me mjet identifikimi, me ID: J10325120D , emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar.

Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka te drejtë e detyrohet tē:

- a) kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë tē dhënët e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tē posaçme me rëndësi tē veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) te bleje dhe te shese, ne emer te shoqerise, prona dhe pasuri te palujteshme si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashtë territorit te saj;

Administratori eshte i detyruar tē thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve tē ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve tē para pas regjistrimit tē saj, propozon tē blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tē certifikuara,

Administratori ka tē drejtë tē kryeje tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshëm e tē jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara tē gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tē huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo tē huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore tē gjitha shkallevet. Administratori ka tē gjitha kompetencat për tē vepruar në marrëdhënie me tē tretët në emër tē shoqërisë, në tē gjitha rrethanat me përjashtim tē kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me tē tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj tē tretëve kur ajo provon se tē tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur tē tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se yetëm shpallja e statutit nuk është provë e

mjaftueshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vinit të parë finanziar që fillon nga data e regjistrimit të shoqerisë në QKB dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerisë

Shperndarja ose prishja e shoqerisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoperi në likuidim e sipër ".

Neni 13
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqiperisë.


Neni 14
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket Themelues te shoqërisë tregtare, Olsi Zoto, Elvis Sina, Abdurrahim Palushi. nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.


ORTAKET E SHOQERISE

Olsi Zoto,



Olsi Zoto

Elvis Sina,



Elvis Sina

Abdurrahim Palushi



Abdurrahim Palushi